



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_/\_\_/2021

**PËR**

**SHPLLJEN E KONKURIMIT TË HAPUR  
PËR  
VENDET VAKANTE PRANË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit 111/2018 "Për Kadastrën", neni 11, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, shpall konkurimin për pozicionin vakant, si më poshtë:

**I. Zëvendës drejtor (1)**, Kategoria: III-a/1. Niveli minimal i diplomës "Master Shkencor", në profilet: Inxhinieri, gjeodezi, drejtësi, ekonomi, ose administrim publik, **në Drejtorinë Vendore të ASHK-së Kamëz-Vorë**

❖ **Kushtet që duhet të plotësojë kandidatët:**

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme, si vijon:**

- Për pozicionin "Zëvendës drejtor" duhet të zotërojnë diplomë të Arsimit të Lartë, nivelit minimal "Master Shkencor", në profilin e kërkuar dhe, të kenë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në profesion në organet e administratës shtetërore.  
*(Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë Institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi);*
- Të mos kenë masë largim nga puna në fuqi dhe të mos kenë, masë disiplinore në fuqi (për shkelje të rënda në kryerjen e detyrës).
- Të ketë aftësi të mira analitike si dhe përgjegjshmëri të lartë;
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Të ketë aftësi të punës në grup;
- Të ketë njohuri të programeve kompjuterike;
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së.
- Preferohet të kenë trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse.

❖ **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit.**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin, si më poshtë:

- a) Kërkesë/letër interesi, për pozicionin për të cilin është i interesuar kandidati.
- b) Jetëshkrim (CV)
- c) Fotokopje të diplomës dhe listës së notave *(përfshirë edhe diplomën Bachelor)*. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit;
- d) Fotokopje të librezës së punës *(të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);*
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Çertifikatë familjare

- g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore,
- h) Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces në proces hetimi),
- i) Vërtetim nga gjykata (që nuk është në proces gjyqësor).
- j) Vërtetim të gjendjes gjyqësore/ Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore
- k) Formularin e dekriminalizimit
- l) Vërtetim që nuk ka, masë disiplinore në fuqi (për shkelje të rënda në kryerjen e detyrës).
- m) Referenca (vleresime) të punëdhënësve të mëparshëm
- n) Adresën e saktë të vendbanimit, email dhe kontakt telefonik.
- o) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- **Dokumentacioni i përcaktuar në pikat “g”, “h”, “i” dhe “j” duhet të jetë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga momenti i aplikimit.**

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet, nëpërmjet postës zyrtare, apo dorazi në Zyrën e Protokollit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-sw, ose në adresën elektronike të ASHK-sw [punesime@ashk.gov.al](mailto:punesime@ashk.gov.al)

**Çdo aplikant i cili, brenda afatit të përcaktuar, nuk dërgon të gjithë dokumentacionin e kërkuar, apo paraqet dokumentacion jashtë afatit të vlefshmërisë humbet automatikisht, të drejtën e vijimit të fazave të konkurimit.**

**Dorëzimi i dokumenteve duhet të bëhet brenda datës: 27.12.2021.**

**❖ Shpallja e rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kandidaturave.**

Në datën **29.12.2021**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore do të njoftojë kandidatët individualisht, (nëpërmjet adresës së e-mail), si dhe nëpërmjet publikimit në ambientet e Drejtorisë Vendore përkatëse, të informacioneve në lidhje me listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret, fazat e testimit, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

**❖ Fushat e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim :**

**I.** Kandidatët do të testohen me shkrim rreth njohurive mbi legjislacionin e mëposhtëm: Kushtetutën e RSH; Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe aktet nënligjore përkatëse; Ligji 20/20 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe aktet nënligjore përkatëse; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”; Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i RSH”, i ndryshuar. (Dispozitat mbi pronësinë); Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i RSH”, i ndryshuar; Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; Ligji nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës më administratën publike”, i ndryshuar; Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me fushën përkatëse.

**Vlerësimi i kandidatëve**

Kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të nënshtrohen procedurave të mëtejshme të vlerësimit, nga një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim, në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 30 pikë

*Gjatë intervistës do të vlerësohen në lidhje me: Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionet për të cilat aplikojnë; Eksperiencën e tyre të mëparshme si dhe motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën).*

c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 30 pikë.

Kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistën e strukturuar me gojë kandidatët të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim të paktën gjysmën e pikëve (20 pikë)

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK, Rr. "Dora D'Istria", Nr.2, Tiranë. Kandidatët që kualifikohen të marrin pjesë në intervistën me gojë do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve (nëpërmjet adresës së e-mail) mbi datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

#### **❖ Shpallja e rezultateve të konkurimit**

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail të paraqitur ne dokumentacionin e aplikimit).

Kandidati që merr më pak se 50 pikë në total nuk konsiderohet i suksesshëm.

**DREJTORI I PERGJITHSHEM**

**ARTAN LAME**